



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:151383

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474541

PPP.nr. 26/22

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË -DEGA NE MALISHEVË-Departamenti i Përgjithshem-Divizioni Civil, si përmbarimore e përberë nga Gjyqtari Individual Nehat Qelaj, si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina, në çështjen juridike të Kreditorit T. Sh.A, me seli në P., e përfaqësuar nga C. L. LLC, Rr. N. T.’, nr....., kundër debitorëve B. M. dhe K. M. nga fshati D., Komuna e M., të cilët i ka përfaqësuar me autorizim me shkrim av. Fitim Gashi nga Prishtina, për shkak të borxhit në shumë prej **6,427.46 (€) euro**, gjykata duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit ushtruar kundër Urdherit për Lejimin e Përmbarimit të Përmbaruesit Privat Mehdi Reshani nga Prizreni P.nr.291/2022, i datës 13.05.2022 gjykata jashtë seancës me dt: 19.03.2024 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET në tërësi prapësimi i debitorëve B. M. dhe K. M. nga fshati D., Komuna e M., ashtu që **ANULOHET** Urdhëri për Lejimin e Përmbarimit P.nr.291/2022, i datës 13.05.2022, i Përmbaruesit Privat M. R. nga Prizreni, për shkak se kërkesa e kreditorit është e **Parashkruar**.

A r s y e t i m

Kreditori T. Sh.A, me seli në P., ka parashtruar propozim për përmbarim, kundër debitorëve B. M. si kredimarrës dhe K. M. bashkëkredimarrës nga fshati D., Komuna e Malishevës, për pagesën e borxhit shumë prej 6,427.46 në emër të marrveshjes për kredinë konsumuese nr... të datës 07.02.2014, dhe sekuestrimin e kolateralit në emër të pengut.

Përmbaruesi Privat me Urdherin për Lejimin e Përmbarimit P.nr.291/2022, i datës 13.05.2022, ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitorët përmes të autorizuarit të tyre Av. Fitim Gashi nga Prishtina, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, me të cilën e konteston në tërësi si të pa bazuar Urdhërin për përmbarim P.nr.291/2022 i datës 13.05.2022, i nxjerrë nga

Përmbartuesi Privat M. S. R. në Prizren, sipas propozimit të kreditorit të datës 13.05.2022, për shkak se dokumenti në bazë të cilit është marrë vendimi përmbartues ose urdhëri përmbartues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë konform nenit 22 lidhur me nenin 36 dhe 38 të LPP-së, ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbartimi, si dhe, hkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për procedurën përmbartimore.. Ndër te tjera ka theksuar se me propozimin për përmbartim (për sekuestrim të kolateralit) të datës 13.05.2022, kreditori T. SH.A. me seli në P., e përfaqësuar nga "C. L." LLC, meseli në Prishtinë, ka kërkuar nga Përmbartuesi Privat M.S. R. në Prizren, që të caktoj përmbartimin kundër debitorëve B.dhe K. M., ashtu që tënjëjt tëdetyrohen t'ia paguajnë kreditorit borxhin në shumën prej 6,427.46 Euro, kamatën e rregulltë dhe kamatë vonesat që do të arrinë deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA MD nr. 06/2014, të gjitha në afat prej shtatë (7) ditësh.Përmbartuesi privat, pa analizuar fare shkresat e lëndës e në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, me Urdhërin P.nr.291/2022 të datës 13.05.2022 (të njëjtën ditë), ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit. Edhe në rast se dokumentit përmbartues - marrëveshjes mbi pengun sipas të cilit përmbartuesi ka lejuar përmbartimin në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, do t'i përmbante të gjitha elementet e cekura më lartë, debitorët e kundërshtojnë urdhërin për përmbartim bazuar në faktin se ka kaluar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbartimi, çka i bie se përveç qëështë arritur parashkrimi për realizimin e kërkesës së kreditorit (neni 353 i LMD-së), është parashkruar edhe vet e drejta e realizimit të kërkesës së kreditorit (neni 354 i LMD-së), Kjo për faktin se nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë (dt. 07.04.2014 kësti i parë 07.03.2019 kësti i fundit) e deri në kohën e nxjerrjes së urdhrit përmbartimor (13.05.2022), kanë kaluar më tepër tre (3) vite, përkatësishtnga arritja për pagesë e kërkesës më të vjetër të pa përmbushur pas së cilës debitori nuk ka kryer dhënie, që i bie të jetë dt. 07.04.2014 - kësti parë sepse debitorët asnjëherë nuk kanë paguar,e deri në kohën e nxjerrjes së urdhrit përmbartimor (13.05.2022), kanë kaluar më tepër se pesë (5) vjet, pra është parashkruar edhe vet e drejta e realizimit të kërkesës së kreditorit në kuptim të nenit 354 të LMD-së. Në këtë, përveç se është parashkruar kërkesa e kreditorit, është parashkruar edhe vet e drejta për realizim të borxhit,e me tëështë parashkruar edhe e drejta e sigurimit sendor - pengu,sipas dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve lidhur me nenin 71 parag. 1, nënparag. 1.4 të LPP-së, pasi që ka kaluar afati ligjor prej kur kreditori ka mund të kërkoj realizimin e kërkesës së tij deri në fillimin e procedurës së përmbartimit. Në këtë kontekst, me parashkrimin(shuarjen) e kërkesës kryesore (realizimit i borxhit të kredisë - detyrimin kryesor) të kreditorit,është shuar edhe e drejta e pengut konform nenit 256, paragrafi 2 i LMD me të cilin përcaktohet se me shuarjen e detyrimit kryesor shuhet dorëzania, pengu dhe të drejtat tjera aksesore, nga aryetimet e cekura, kërkojmë nga Gjykata Themelore në Gjakovë — Dega në Malishevë, që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konform dispozitave të LPP-së, të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorëve B.M. dhe K. M., me adresë në fshatin D., Malishevë, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Fitim Gashi, Avokat në Prishtinë, ashtu që të anulohet Urdhëri për përmbartim P.nr.291/2022, i dates, të detyrohet kreditori T. SH.A. me seli në P., e përfaqësuar nga "C. L." L., që t'ia paguaj debitorëve shpenzimet në emër të përpilimit të këtij prapësimi në shumën prej 312.00Euro, dhe të gjitha shpenzimet tjera që dalin nga ky rast, sipas TOAK-së.

Përmabruesi Privat e ka njoftuar kreditorin lidhur me parashtrimin e prapësimit nga ana e debitorëve, dhe i njëjti është njoftuar lidhur me të drejtën e parashtrimit të përgjigjës në prapësim, ndërsa në afatin ligjor të njëjtën nuk e ka parashtruar.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorëve është i bazuar, për faktin se borxhi i ngarkuar për debitorët është borxh i parashkruar, duke marrë për bazë faktin se kreditori propozimin për përmbarim e ka bërë me datë 13.05.2022, ndërsa sipas shkresave të lëndës bashkangjitur propozimit për përmbarim rezultoi që marrëveshjes mbi kredinë konsumuese e lidhur mes palëve ndërgjyqëse rezultoi të jetë e vitit 07.02.2014, ndërsa me shiqimin e të njëjtave nuk vërtetohet që debitorët kanë përmbaruar detyrimet e tyre në kuptimin e pagesës së ndonjë kësti të përcaktuar sipas marrëveshjes së kredisë, e që një gjendje e tillë faktike rregullohet edhe me dispozitat e nenit andaj bazuar në nenin 353 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, parashihet citoj **“Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike aksesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë.”**, në dispozitën e nenit 354 par 1. lidhur me parashkrimin i vet të drejtës përcaktohet se 1. **“Vetë e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike parashkruhet për pesë (5) vite duke llogaritur nga arritja për pagesë e kërkesës më të vjetër të pa përmbaruar pas së cilës debitori nuk ka kryer dhënie”**, ndërsa në par 2 përcaktohet se **“Kur parashkruhet e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike, atëherë kreditori humb të drejtën jo vetëm të kërkojë prestime të ardhshme periodike, por edhe prestime periodike të cilat kanë arritur për pagesë para këtij parashkrimi”**, për çka gjykata vlerëson se në rastin konkret nga dita e arritjes së detyrimit të debitorëve e deri në paraqitjen e propozimit për përmbarim ka kaluar mbi një vit, afat ky prekluziv i përcaktuar sipas LMD-së, dhe se një e drejtë e tillë për kreditorin është parashkruar.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e kreditorit lidhur me atë se në mes tij dhe debitorëve ekziston një marrëveshje mbi kredinë, dhe në vështrim të këtij pretendimi, për gjykatën nuk ishte kontestuese se ekziston një marrëveshje e tillë, dhe që debitorët nuk e kanë përmbaruar e njëjta theksohet edhe në propozimin për përmbarim megjithatë pretendimi se debitori ka bërë pagesa të kohë pas kohshme në emër të borgjit, gjykata i konsideroi të pa bazuara pasi që me asnjë provë të vetme kreditori nuk ka arritur të argumentoi se debitorët kanë bërë një përmbarim të detyrimit të ndonjë kësti të arritur, ndërsa sa i përket propozimit për sekuestrim të kolateralit, poashtu e njëjta nuk mund të ekzekutohet dhe të mbetet titull, përmbarimor, ngase në dispozitat e LMD-së lidhur me pengun dhe të drejtat aksesore në nenin 276 përcaktohet se **“Detyrimi shuhet kur ai përmbarohet si dhe në rastet tjera të përcaktuara me ligj, me shuarjen e detyrimit kryesor shuhen dorëzania, pengu dhe të drejtat tjera aksesore”**, andaj nga një gjendje e tillë faktike dhe bazuar në shkresat e lëndës u konstatua se prapësimi i debitorëve është i bazuar dhe mbi bazën e argumenteve të sqaruara u vendos si në dispozitiv.

Prandaj, gjykata, mbi bazën e arsyeve të cekura më lartë, bazuar në nenin 71 dhe 73 të Ligjit për Procedure Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorëve është i bazuar, prandaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË-DEGA NË MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
PPP.nr.26/22, dt: 19.03.2024

GJYQTARI
Nehat Qelaj

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 ditësh, nga dita vijuese pas ditës se pranimit te këtij aktvendimi, Gjykatës se Apelit ne Prishtine, përmes kësaj gjykate.